



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdatë
Nr.	protnumber

Data: xx.xx.2025

Nr: xx

Ora: xx:xx

VENDIM

PËR

DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DY QENDRAVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 09 NËNTOR 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

VËREJ:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Për QV nr. 2521/00, ambient privat “Baftjar Muça”, QV nr. 2534/0, ambient privat, “Mehmet Plaka”, të Qarkut Elbasan, Bashkia Cerrik, nga bashkia përkatëse është depozituar kërkesa për dhënien e autorizimit nga Komisioneri Shtetëror I Zgjedhjeve, pasi kanë konstatuar se vendndodhja e dy qendrave të votimit, nuk plotëson kushtet teknike,(kati i dyte , me shkallë të vështira për ngjitje) , te zhvendosen , QV 2521/00 në Shkollën 9-vjecare “Adem Asllani”, QV 2534/00 në objekt privat ,”Lumturi Baku”.

Data: 00.00.2025 Nr: 00
Ora: 12:00



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025”

VENDOS:

1. Dhënien e autorizimit për dy qendra të votimit me vendndodhje sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij, ndryshojnë vendndodhjen sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Lidhja nr. 1

Qarku	Bashkia	Nj. Administrative	QV	Adresa
Elbasan	Cerrik	Shtëpanj	2521/00	Ambient Privat “Baftjar Muca”
Elbasan	Cerrik	Gostme	2534/00	Ambient Privat”Mehmet Plaka”

Lidhja nr. 2

Qarku	Bashkia	Nj. Administrative	QV	Adresa
Elbasan	Cerrik	Shtëpanj	2521/00	Shkolla 9-Vjecare “Adem Asllani ”
Elbasan	Cerrik	Gostime	2534/00	Ambient Privat”Lumturi Baku”

Data: 25.4.2025 Nr: 643
Ora: 12:00



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme per kryetar bashkie të datës 09 nëntor 2025”